

MARRËVESHJA PËR KUFIZIMIN E KONKURRENCËS

Kjo marrëveshje për kufizimin e konkurrencës nga ana e Punëmarrësit (më tej e quajtur "Marrëveshja") bëhet e vlefshme në datën [DATA],

NDËRMJET: [EMRI I PUNMËARRËSIT] ("Punëmarrësi"), një individ me vendbanimin në adresën:
[ADRESA E PLOTË]

DHE: [EMRI I KOMPANISË SUAJ] ("Kompania"), një shoqëri tregtare, që është themeluar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar me zyrën e vet qendrore në adresën:
[ADRESA JUAJ E PLOTË]

1. MARRËVESHJA PËR MOSPËRFSHIRJE NË AKTIVITET KONKURRUES

Si një arsye më tepër për punësimin e kandidatit, Kompania do të prirret të punësojë kandidatin, që pranon se, nëse një punësim i tillë ndërpritet për çfarëdolloj arsyeje, punëmarrësi zotohet se nuk do të përfshihet në mënyrë direkte, apo të tërthortë, për një periudhë prej [PERIUDHA KOHORE] pasi janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, qoftë personalisht, ose në cilësinë e një punëmarrësi, kandidati për ortak, ortaku, administratori, apo ndryshe, në çdo lloj forme, qoftë me anë të një kompanie, qoftë mjete tjetër, në një aktivitet tregtar të natyrës [LLOJI I AKTIVITETIT], brenda një territori gjeografik [SHËNOHET TERRITORI GJEOGRAFIK] dhe nëse gjen zbatim, zotohet, se as nuk do të: porosisë për të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin territor gjeografike, në mënyrë të drejtpërdrejtë, a të tërthortë, nga ndonjë klient, apo Kompani, apo nga ndonjë klient i pasardhësve të saj, për ato produkte, që shiten nga Kompania apo nga pasardhësit e saj, qoftë ai vetë, qoftë në cilësinë e një punëmarrësit të një personi tjetër fizik, a juridik në formën e tregtarit të regjistruar, a shoqërive tregtare.

2. PËRKUFIZIMI I KUSHTEVE

Shprehja "mospërfshirje në konkurrencë" në kuptimin që është përdorur këtu, nënkupton që Punëmarrësi nuk do të jetë pronar, nuk do të drejtojë, zbatojë, konsultojë, apo do të punësohet në një aktivitet tregtar, që është thelbësisht i ngjashëm, ose konkurrues, me aktivitetin tregtar aktual, të Kompanisë, apo me ndonjë aktivitet tjetër tregtar, në të cilin Kompania mund të përfshihet në mënyrë të konsiderueshme, gjatë periudhës së punësimit të punonjësit.

Konkurrenca nënkupton që punëmarrësi, ose të jetë pronar i një kompanie, ose të punojë për një kompani tjetër të llojit: [SPECIFIKO LLOJIN E BIZNESIT, KU PUNËMARRËSI NUK MUND TË PËRFSHIHET].

3. SEKRETET TREGTARE

Punëmarrësi e pranon se Kompania në varësi të kësaj marrëveshjeje mund t'i vërë në dispozicion, apo t'i japë punëmarrësit qasje në sekretet tregtare, të dhënat mbi klientët dhe të tjera të dhëna me natyrë konfidenciale, si dhe të emrit të mirë. Punëmarrësi pajtohet që do t'i mbajë për vete këto informacione të cilësuar të rezervuara, dhe nuk do ta përdorë informacionin e sipër-shkruar për llogari të vet, apo t'ia bëjë të ditur këtë informacion palëve të treta.

Punëmarrësi do të ndërmarrë veprimet e duhura me qëllim ruajtjen e të dhënave që përbëjnë sekret tregtar të Kompanisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to: informacionin për klientët, furnizuesit,

informacionin financiar, mbi kërkim-zhvillimin, ai zotohet se nuk do t'i zbulojë të dhënat që përbëjnë sekret tregtar të Kompanisë asnjë pale të tretë, gjatë dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës.

4. KLAUZOLA E POSAÇME E MOSPËRFSHIRJES NË KONKURRENCË

Me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës ndërmjet Punëmarrësit dhe Kompanisë, pavarësisht arsyes së ndërprerjes së tyre, Punëmarrësi nuk do të tentojë të përfitojë asnjë klient të Kompanisë, që ka qenë klient i Kompanisë gjatë periudhës së kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës ndërmjet Punëmarrësit dhe Kompanisë, pavarësisht nëse ai vazhdon, ose jo, të jetë klient i Kompanisë, si dhe pavarësisht nëse të dhënat e klientit konsiderohen, ose jo, informacion konfidencial, si dhe nuk do të ndihmojë apo asistojë në asnjë mënyrë tjetër, çfarëdo personi që kërkon të përfitojë një klient të tillë për një periudhë kohe prej [PERIUDHA E KOHËS], nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit.

5. DËMSHPËRBLIMI

Punëmarrësi bie dakord që të paguajë kushtin penal në masën prej [SHUMA NË LEKë] për çdo shkelje të detyrimit për mospërfshirje në konkurrencë, sipas kësaj Marrëveshjeje.

6. MARRËVESHJA E DETYRUESHME

Nëse këto zotime, për çfarëdo arsye rezultojnë të pavlefshme në ndonjë pjesë të tyre, palët e poshtëshënuara, bien dakord, që ajo pjesë mund të hiqet, pa cënuar vlefshmërinë e pjesëve të tjera, apo zbatueshmërinë e pjesës së mbetur të zotimeve.

Kjo marrëveshje për mospërfshirje në aktivitet konkurrues do të zbatohet vetëm për zonën gjeografike [SHËNOHET ZONA GJEOGRAFIKE] dhe do të jetë në fuqi për një numër të plotë vitesh [NUMRI I VITEVE] duke nisur nga data e ndërprerjes së punësimit.

Kjo marrëveshje ka fuqinë e ligjit për palët, pasardhësit e tyre, të deleguarit dhe përfaqësuesit.

Në dëshmi të sa më sipër çdonjëra nga palët e kësaj marrëveshjeje, ka dashur, që ajo të lidhet në (VENDI I LIDHJES) në datën e përcaktuar më poshtë

KOMPANIA

PUNONJËSI

Nënshkrimi i autorizuar

nënshkrimi i autorizuar

Emri dhe mbiemri në germa shtypi dhe pozicioni

Emri dhe mbiemri në germa shtypi dhe pozicioni